



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:191998

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876194

KPPP.nr.1442/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “DLD Group” me numër unik identifikues 819841636 me seli në Prishtinë Lagja Pejton rr. “Perandori Justinian” Nr.25, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdullah Hoti avokat nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, rr. “UÇK” duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.616/23 të datës 24.08.2023 të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.616/23 i datës 24.08.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “DLD Group” ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.616/23 të datës 24.08.2023 me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës më numër 2022/0018, të datës 15.08.2022 në lartësi prej 1,000.00€, Urdhër pune i datës 15.08.2022 dhe Dokumenti i dorëzimit të faturës 2022/0018 me nr.prot.10-410/02-0218554/22 i datës 11.10.2022, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 1,000.00€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore. Të gjitha këto detyrime duhet të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit të hapura në bankat komerciale dhe

bartjen e tyre në llogarinë bankare apo përmes përmbarimit dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen të bëhet inkasimi i borxhit.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se fatura në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi është dorëzuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, po ashtu ka theksuar se si e tillë kjo faturë nuk mund të jetë objekt i përmbarimit për faktin se propozimi për përmbarim është ushtruar në mënyrë sipërfaqësore dhe pa dokumentacion relevant me të cilin vërtetohet se si ka ardhur deri tek kjo faturë. Gjykatës i ka propozuar që të merr aktvendim me të cilin pranohet prapësimi i debitorit dhe abrogohet Urdhri përmbarimor P..nr.616/23 të datës 24.08.2023.

Kreditori përmes përgjigjes në prapësim ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se procedura përmbarimore bazohet mbi dokumentin e besueshëm faturën e cila është pranuar me rregull nga ana e debitorit. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe Urdhrin Përmbarimor P.nr.616/23 të datës 24.08.2023 ta lë në fuqi. Po ashtu, i ka propozuar gjykatës që në rast të ushtrimit të ankesë nga debitori të caktoj garancionin në përputhje me nenin 78 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata vlerëson se përmbaruesi privat ka lejuar urdhrin përmbarimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës më numër 2022/0018, të datës 15.08.2022, faturë kjo e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjen se fatura e cila është objekt i kësaj procedure të përmbarimit, është lëshuar me rregull nga ana e debitorit, e njëjta është pranuar dhe nënshkruar nga debitori së bashku me urdhëresën e punës në të cilën konfirmohet shërbimi “Instalimi i E-Kioskut” , instalimi i programit të ri dhe pastrimi i Smart Hooper dhe NV200, dhe rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e faturës dhe detyrimin që buron nga e njëjta. Po ashtu, objekti i faturave rezulton të jetë identik me urdhrin e punës.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1442/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.